



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 56, dt. 02.04. 2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 02.04.2015, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohen projektet e restaurimit të TIKÀ-s me këto vërejtje:
*Të mos ndryshojë konstruksioni dhe materiali i çative për të katër objektet.
Restaurimi duhet të marrë parasysh ruajtjen e strukturave origjinale të çative ekzistuese duke zëvendësuar vetëm elementët e dëmtuar të konstruksionit të saj si dhe të zëvendësohen vetëm tjegullat e dëmtuara të çative me tjegulla vendi me të njëjtat karakteristika si origjinalet. Të detajohen grafikisht strukturat e përkohshme të mbulimit për secilin objekt. Materiali grafik i rilevimit të objekteve në format dëg të depozitohet pranë IMK.*
 - **Lidhur me projekt restaurimin “Xhamia e Beqarëve”, Berat, sugjerohet:**
Të hiqen kangjellat metalike të dritareve me harqe.
 - **Lidhur me projekt restaurimin “Xhamia Mbret”, Berat:**
*Të bëhet sistemimi i sheshit të oborrit me kalldrëm në hapësirën ku aktualisht ndodhet një lulishte.
TIKÀ duhet të procedojë tek Agjencia e Shërbimit Arkeologjik lidhur me gërmimet që parashikohen të bëhen në këtë shesh.*
 - **Lidhur me projekt restaurimin “Teqeja e Helvetive”, Berat.**
Të ndërrohen vetëm elementet që janë të dëmtuara.
 - **Lidhur me projekt restaurimin “Xhamia e Et’hem Beut”, Tiranë.**
Të mos hiqen vetratat e dritareve të hajatit, por të respektohet vendimi i mëparshëm i KKR.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI